



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

ANALIZA E AVOKATIT TË POPULLIT PËR VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE NË RASTIN NR. KO22/15

Kërkesë për shfuqizimin e Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës nr. DKGJK-001-2014 të datës 31 gusht 2014 “për konfirmimin e vazhdimin të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”

PËRMBAJTJA

I. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese pretendon se kërkesa e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e Dekretit të Presidentes ishte e papranueshme sepse ngritja e një kërkesë të tillë nuk hynte në kompetencat e Avokatit të Popullit, por ky pretendim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Komentarin e Enver Hasanit dhe Ivan Çukaloviç mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, praktikat ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, madje edhe me praktikat dhe pohimet e vetë Gjykatës Kushtetuese në raste të mëhershme.

II. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese pretendon se nuk kishte nevojë për kuorumin prej shtatë gjyqtarësh për të nxjerrë Aktvendimin në Rastin KO155/14, por ky pretendim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, si dhe me shpjegimet e mëparshme të vetë Gjykatës Kushtetuese në prononcimin e saj për media.

III. Dështimi i Gjykatës për të përjashtuar kryetarin Hasani dhe gjyqtarët Botusharova-Doicheva dhe Rodrigues nga pjesëmarrja në procedurën e Rastit KO22/15, ka qenë plotësisht i pajustificuar dhe i paarsyetuar, si dhe është në kundërshtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese dhe Kodin e mirësjelljes për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

IV. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO22/15 pretendon se Dekreti i Presidentes është në linjë me marrëveshjen ndërkombëtare, por, njësoj si në Rastin KO155/14, nuk jep asnjë argument për këtë pretendim, nuk citon asnjë fjalë të marrëveshjes ndërkombëtare që mund të mbështesë këtë interpretim dhe nuk i përgjigjet asnjë argumenti të Avokatit të Popullit mbi këtë pikë.

I. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese pretendon se kërkesa e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e Dekretit të Presidentes ishte e papranueshme sepse ngritja e një kërkesë të tillë nuk hynte në kompetencat e Avokatit të Popullit, por ky pretendim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Komentarin e Enver Hasanit dhe Ivan Çukaloviç mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, praktikat ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, madje edhe me praktikat dhe pohimet e vetë Gjykatës Kushtetuese në raste të mëhershme.

A.

Siç pranon vetë Gjykata, pikënisja e vlerësimit të pranueshmërisë së një kërkesë të ngritur nga Avokati i Popullit është neni 113, par. 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Gjykata rithekson se ajo merret me kërkesa të parashtruara sipas nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 2, të Kushtetutës” (Rasti Nr. KO22/15, Aktvendimi, par. 27, në tekstin e mëtejshëm: *Aktvendimi*). Ky paragraf përcakton shprehimisht se Avokati i Popullit është “[i] autorizuar të ngre[j]ë rastet . . . e përputhshmërisë së . . . dekreteve të Presidentit . . . me Kushtetutën”. Gjithashtu, përveç nenit 113, par. 2, Kushtetuta përcakton se “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute” (neni 135, par. 4).

Këto dispozita kushtetuese, shprehimisht dhe në mënyrë të prerë, i delegojnë Avokatit të Popullit kompetencën për të ngritur çështje para Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë çështje të përputhshmërisë së dekreteve të Presidentit me Kushtetutën. Prandaj, edhe një lexues me njohje minimale të Kushtetutës dhe së drejtës kushtetuese mund të çuditet kur lexon në Aktvendimin e Gjykatës se “parashtruesi i kërkesës nuk ngre ndonjë çështje që eventualisht do të hynte në kuadër të kompetencës së tij, siç parashihet me dispozitat kushtetuese” (*po aty*, par. 31). Përderisa dy nene të Kushtetutës përcaktojnë shprehimisht dhe qartë se Avokati i Popullit ka kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht për të kontestuar kushtetutshmërinë e “dekreteve të Presidentit” përpara kësaj Gjykate, si ka mundësi që Gjykata ta hedhë poshtë kërkesën në Rastin KO22/15 për shkak të mungesës së kompetencës?

Në përpjekje për të justifikuar këtë veprim të pajustificueshëm, Gjykata pretendon të vendosë kushte mbi kompetencën e Avokatit të Popullit për të ngritur çështje kushtetuese. Siç do të argumentohet më poshtë, kushtet e propozuara nga Gjykata Kushtetuese janë plotësisht të shpikura dhe nuk kanë asnjë bazë juridike. Por, edhe para se të hyjmë në hollësitë e këtyre kushteve, mund të vërejmë se kompetenca e Avokatit të Popullit është e *pakushtëzuar* në tekstin e Kushtetutës. Prandaj, *parimisht*, në bazë të tekstit të Kushtetutës, dihet prej fillimit se çdo përpjekje e Gjykatës për të shtuar kushte *ex officio* mbi kompetencën e Avokatit të Popullit për të ngritur raste para Gjykatës, pavarësisht se cilat janë kushtet e shtuara, dështon menjëherë. Madje, ky parim nuk po shpallet për herë të parë tani, nga Avokati i Popullit. Përkundrazi, ky parim

është shpallur para dy vitesh, nga vetë kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Enver Hasani dhe z. Ivan Çukalović: “katër subjektet e autorizuara **janë plotësisht të lira** që të procedojnë kurdoherë çështje para Gjykatës brenda jurisdiksionit të tillë [të përcaktuar në nenin 113, par. 2], **pa pasur nevojë të plotësojnë ndonjë kusht specifik**” (E. Hasani dhe I. Cukalovic, *Komentar: Kushtetuta e Republikës së Kosovës* (2013), f. 573, theks i shtuar).¹ Prandaj, edhe sipas vetë kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Gjykatës, përpjekja për të vendosur kushte mbi të drejtën e Avokatit të Popullit për të ngritur raste përpara Gjykatës, parimisht, është **mission i dështuar** që në fillim. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për të deleguar dhe për të mohuar kompetenca të institucioneve të tjera kushtetuese në Republikën e Kosovës. Ky veprim përbën një **arrogancë brutale të aktivizmit gjyqësor** në rregullimin kushtetues.

B.

Pavarësisht nga parimi i përgjithshëm që kompetenca e Avokatit të Popullit për të kontestuar kushtetutshmërinë e dekreteve të Presidentit është e pakushtëzuar, kur fillojmë të trajtojmë **hollësitë** e kushteve specifike të propozuara nga Gjykata, misioni i dështuar i Gjykatës shndërrohet në katastrofë intelektuale. Gjykata propozon dy kufizime mbi të drejtën e Avokatit të Popullit për të ngritur raste para Gjykatës Kushtetuese.

Së pari, Gjykata pretendon se kërkesa e Avokatit të Popullit “nuk hyn në fushveprimin e [nenit 113, par. 2 të Kushtetutës], siç mund të konkludohet nga analiza dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese (Shih Rastin KO97/12, parashtrues i kërkesës: *Avokati i Popullit*, Aktgjykimi i 12 prillit 2013)”, sepse “parashtruesi i kërkesës dështon të pohojë ndonjë shkelje të dispozitave specifike kushtetuese lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të tij, ose të ndonjë individi a grupi të individëve” (Aktvendimi, par. 29 dhe 31).

Ky pretendim i Gjykatës dështon për arsye të shumta. Le të fillojmë duke vërejtur se, për çudi të madhe, i vetmi rast që Gjykata e citon për të dëshmuar “praktik[ën] gjyqësore [të] Gjykatës Kushtetuese”, Rasti KO97/12, jo vetëm që **nuk e mbështet** pretendimin e saj që Avokati i Popullit mund të ngrejë raste vetëm kur pretendon shkelje të dispozitave lidhur me të drejtat dhe liritë themelore, por edhe **e kundërshton shprehimisht** këtë pretendim. Në Aktgjykimin e Rastit KO97/12, deklarohet shprehimisht se: “Gjykata konsideron se gjuha e nenit 113.2 të Kushtetutës është **e qartë** dhe **pa ekuivoke**, se autorizimi i Avokatit të Popullit për të

¹ Duhet theksuar se kur flasim për kompetencën e Avokatit të Popullit për të ngritur çështjen e kushtetutshmërisë së dekreteve të Presidentit si kompetencë **të pakushtëzuar**, po u referohemi kushteve **substanciale**, jo **procedurale**. Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit nuk vendosin asnjë kusht **substancial** mbi ushtrimin e kësaj kompetence, dmth., kushte lidhur me përmbajtjen e kërkesës, por megjithatë, ekzistojnë disa kërkesa **procedurale** që duhet të përmbushen për pranimin e kërkesës, si p.sh., respektimi i afatit gjashtëmuor pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar (shih Ligjin 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 30). Siç do të vërehet më poshtë, në Rastin KO22/15 Gjykata përpiket të vendosë kushte **substanciale**, *ex officio*, mbi të drejtën e Avokatit të Popullit për të kontestuar kushtetutshmërinë e dekreteve të Presidentit, gjë që nuk ka kurrfarë baze në Kushtetutë, as në ligj.

iniciuar kërkesa në Gjykatë Kushtetuese ***nuk është i kufizuar sipas Kapitullit II të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore]*** (Rasti KO97/12, Aktgjykimi, par. 110, theks i shtuar). Për më tepër, në të njëjtin rast, Gjykata deklaroi për kërkesën e Avokatit të Popullit se: “Pasi parashtruesi është palë e autorizuar, e ka përmbushur afatin e nevojshëm kohor për të parashtruar kërkesë në Gjykatë dhe me saktësi ka përshkruar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, duke përfshirë ligjin e kontestuar të Kuvendit, Gjykata konstaton se parashtruesi i është përmbajtur kriterit të pranueshmërisë” (po aty, par. 112). Shumë e saktë. Por, edhe në Rastin KO22/15, është e pamohueshme se “parashtruesi është palë e autorizuar, e ka përmbushur afatin e nevojshëm kohor për të parashtruar kërkesë në Gjykatë dhe me saktësi ka përshkruar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, duke përfshirë [dekretin] e kontestuar të [Presidentes]”. Mirëpo, në Rastin KO22/15, ndryshe nga Rasti KO97/12, Gjykata ka shpallur të papranueshme kërkesën e Avokatit të Popullit. Kundërshtia e qasjes së Gjykatës në këto dy raste është tepër e qartë. Vetëm një gjë mbetet e paqartë: ***A nuk e ka lexuar Gjykata Aktgjykimin e vet në Rastin KO97/12 para se ta citonte, apo thjesht ka menduar se lexuesit e saj nuk do ta kontrollonin vetë këtë citim?***

Përveç Rastit KO97/12, edhe qasja e Gjykatës në Rastin KO155/14, në të cilin Avokati i Popullit kontestoi Dekretin e Presidentes për herë të parë, krijon probleme për Aktvendimin e fundit. Njësoj si në Rastin KO22/15, në Rastin KO155/14 Avokati i Popullit nuk ka pretenduar, të paktën jo shprehimisht, ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut a lirive themelore. Por, me gjithë këtë mungesë, Gjykata as nuk ka pohuar shprehimisht, as edhe nuk ka sugjeruar, që Avokati i Popullit nuk kishte kompetencë për të kontestuar Dekretin e Presidentes. Përkundrazi, Gjykata theksoi se ishte plotësisht brenda kompetencës së Avokatit të Popullit për ta ngritur çështjen, pa e përmendur fare ndonjë lidhje me Kapitullin II të Kushtetutës: “Në kërkesën e tanishme, Avokati i Popullit sfidon Dekretin nr. DKGJK-001-2014, të nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 31 gusht 2014. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë në bazë të nenit 113.2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës” (Rasti Nr. KO155/14, Aktvendimi, par. 34). Por, është e pamohueshme se edhe në Rastin Nr. KO22/15, “Avokati i Popullit sfidon Dekretin nr. DKGJK-001-2014, të nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 31 gusht 2014.” Prandaj, edhe këtu, Gjykata domosdoshmërisht do të duhej të konkludonte se “parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë në bazë të nenit 113.2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës”.

Mbetet misterioze se cili është shpjegimi i këtij ndryshimi dramatik në qasjen e Gjykatës midis Rastit KO155/14 dhe Rastit KO22/15. Pse në Rastin KO155/14 Gjykata as nuk ka përmendur, as nuk ka sugjeruar, që Avokati i Popullit nuk mund të ngrejë raste pa një lidhje eksplicite me Kapitullin II të Kushtetutës, por papritmas, në Rastin KO22/15, ajo e shpik këtë “fakt” si bazë për të shpallur kërkesën të papranueshme?

Sigurisht që nuk është e rrallë, as e papranueshme, që një Gjykatë Kushtetuese të ndryshojë qasjen e vet në çështje të caktuara me kalimin e kohës. Ndryshime të tilla sigurojnë që Kushtetuta të interpretohet në mënyrë gjithnjë e më progresive, si “instrument i gjallë”, ashtu siç

kërkohet edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.² Por, njëkohësisht, në mënyrë që të ruhen konsistenca, vazhdimësia dhe parashikueshmëria e jurisprudencës së një gjykate, këto ndryshime në interpretim duhet të ndodhin gradualisht, dhe gjithmonë të shoqëruara me argumente bindëse dhe justifikime të forta. Në vend të kësaj, ndryshimi i qasjes së Gjykatës Kushtetuese midis Rastit KO155/14 dhe Rastit KO22/15 ka ndodhur në një periudhë më pak se gjashtëmujore, dhe për më tepër, **pa u shoqëruar me asnjë argument a justifikim**. Nuk ka asnjë shpjegim për këtë ndryshim, përveç dëshirës së dukshme të Gjykatës për të larguar kërkesën e Avokatit të Popullit me çdo kusht, duke kërkuar çdo pretekst të mundshëm, sado absurd që të jetë, për ta zhdukur këtë rast.

Siç po shihet qartë, Gjykata nuk ka gjetur, as nuk mund të gjejë, ndonjë mbështetje në jurisprudencën dhe praktikën e vet gjyqësore për pretendimin që kompetenca e Avokatit të Popullit është e kufizuar sipas Kapitullit II të Kushtetutës, për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Ndoshta duke e ditur edhe vetë këtë gjë, duke qenë e ndërgjegjshme për varfërinë e vet të interpretimit juridik dhe profesional, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të një vendi tjetër, përkatësisht të Gjykatës Kushtetuese të **Republikës së Shqipërisë**. Gjykata citon dy raste të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë që, sipas saj, ofrojnë mbështetje për pretendimin e saj për kufizimin e kompetencës së Avokatit të Popullit. Në këto vendime, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë pohon se “interesi i [Avokatit të Popullit] për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve” (*Aktvendimi*, par. 34, duke cituar Vendimin Nr. 29, të 31 majit 2010, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë); dhe “Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2, të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normative nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve” (*Aktvendimi*, par. 38, duke cituar Vendimin Nr. 40, të 16 nëntorit 2007, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë).

Kjo përpjekje për t’u mbështetur në praktikën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është plotësisht e dështuar. Si fillim, duhet vërejtur që Aktvendimi i Gjykatës është vetëm njëri nga shembujt më banal të një tendence të theksuar të Gjykatës Kushtetuese për të cituar Kushtetutat dhe praktikat gjyqësore të vendeve të tjera, në mënyrë krejt paushalle, pa asnjë shpjegim të metodologjisë me të cilën ka zgjedhur disa vende për krahasim, por jo të tjera. Duke u përpjekur t’i ikë detyrimit parësor për interpretim të Kushtetutës, që është thelbi i misionit të kësaj gjykate, ajo përpiqet të mbulojë këtë ikje me kopjime dhe citime selektive, pa përmajtje dhe pa kuptim, siç konfirmohet edhe në këtë rast.

² Shih, p.sh., *Bayatyan kundër Armenisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aplikimi nr. 23459/03 (2011), par. 98 dhe 102 (“Konventa është një instrument i gjallë që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme dhe të ideve të përhapura në Shtetet demokratike të sotme.”)

Pa dyshim, studimet krahasuese në çështje kushtetuese janë të dobishme për të mësuar nga praktikat më të mira nga vende të tjera, por gjithmonë me kusht që një apo më shumë shtete të një rajoni të caktuar (si p.sh. vendet ballkanike, vendet e Bashkimit Evropian, vendet e Këshillit të Evropës, etj.) të përfshihen në krahasim, ose, në të kundërtën, të shpjegohet në mënyrë eksplicite pse disa vende përfshihen, dhe disa jo. Pa përfshirë të gjitha vendet relevante, ose pa shpjeguar pse disa vende janë përjashtuar, studimi krahasues jo vetëm del i pa vlerë, por edhe e rrënon imazhin e Gjykatës, duke krijuar përshtypjen se po merren në analizë vetëm ato vende që u shërbejnë qëllimeve të Gjykatës, ndërsa vende të tjera lihen menjatë për arsye strategjike. Në këtë aspekt, Rasti KO22/15 është një shembull tejet i skajshëm, i standardeve të ulta të kësaj Gjykate. Në këtë rast, studimi krahasues i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës trajton një vend të vetëm: Republikën e Shqipërisë. Pse Gjykata ka zgjedhur Shqipërinë dhe jo, e zëmë, Slloveninë dhe vende të tjera në të cilat Avokati i Popullit gëzon kompetencën për të ngritur raste para Gjykatës Kushtetuese? Nëse Gjykata ka pasur një arsye, ajo nuk na e tregon këtë, që lë të kuptohet se e ka zgjedhur Shqipërinë për arsye se vetëm aty, dhe jo në ndonjë vend tjetër, ka gjetur mbështetjen që po kërkonte. Kjo mënyrë e përzgjedhjes së rasteve dhe vendeve për një studim krahasues, quhet thjesht selektim negativ për qëllime negative.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vetëm ka *shpresuar* se kishte gjetur mbështetjen e duhur në shembullin e Republikës së Shqipërisë, por kjo ishte një shpresë e kotë. Për shkak të ndryshimeve të dukshme midis Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, praktika gjyqësore e Republikës së Shqipërisë nuk mund të shërbejë si mbështetje për pretendimin që, *në Republikën e Kosovës*, kompetenca e Avokatit të Popullit për të ngritur raste përpara Gjykatës Kushtetuese është e kushtëzuar në lidhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për të kuptuar pse, le të imagjinojmë një rast hipotetik në të cilin Gjykata Kushtetuese pretendon se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të ketë 140 deputetë, jo vetëm 120, dhe për të mbështetur këtë pretendim, Gjykata citon nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet qartë se “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë”. Një argument i tillë do të ishte tejet absurd, sepse Kushtetuta e Republikës së *Kosovës*, ndryshe nga ajo e Shqipërisë, përcakton se Kuvendi i Republikës së *Kosovës* përbëhet nga 120 dhe jo 140 deputetë. Fakti që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton një organizim të ndryshëm për Kuvendin e saj, nuk ka aspak rëndësi për Republikën e Kosovës, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të organizohet sipas Kushtetutës së Kosovës, jo të Shqipërisë — sidomos kur ka kontradikta midis tyre. Nga ky rast hipotetik mund të nxjerrim një parim më të përgjithshëm: në rast se Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe kushtetuta e një vendi tjetër ndryshojnë thelbësisht mbi një pikë të caktuar, atëherë praktika kushtetuese e atij vendi, të paktën mbi atë pikë të caktuar, nuk mund të shërbejë si bazë për praktikën kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Ky parim është kaq i thjeshtë saqë është lehtë i kuptueshëm nga gjithkush, me përjashtim, siç duket, të Gjykatës Kushtetuese. Kur Gjykata i citon dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ajo dështon të përmendë se ato vendime janë bazuar në nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton dhjetë “subjektet” (në gjuhën e

Kushtetutës së Kosovës: “palët e autorizuar”) që mund të ngrenë raste para Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe përcakton për katër nga këto subjekte se: “Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët **dh** [Avokati i Popullit], **e** [organet e qeverisjes vendore], **ë** [organet e bashkësive fetare] dhe **g** [individët] mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre” (neni 134, par. 2). Prandaj, kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shkruan se “Avokati i Popullit, *si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës*, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete” (theks i shtuar), duhet ta kuptojmë këtë parim si të ndërlidhur drejtpërdrejt me një kufizim të veçantë të kompetencës së Avokatit të Popullit në Republikën e Shqipërisë që përcaktohet në tekstin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por që nuk ekziston në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kaq thjeshtë.

Siç kemi parë më sipër, ndryshe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, askund në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk ekziston një kufizim i tillë mbi të drejtën e Avokatit të Popullit për të ngritur raste para Gjykatës Kushtetuese. Askund në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndryshe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nuk përcaktohet se Avokati i Popullit mund të ngrejë raste vetëm kur ka lidhje me “interesat” e tij. Për shkak të këtij ndryshimi thelbësor midis Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përpjekja e Gjykatës për t’u mbështetur tek praktika e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është një dështim i plotë. Fakti që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshe nga ajo e Kosovës, e kufizon këtë kompetencë, është po aq jorelevant për Republikën e Kosovës sa është fakti që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshe nga ajo e Kosovës, përcakton se Kuvendi duhet të përbëhet nga 140 deputetë. Në një moment më të ndershëm të jetës së tyre profesionale, kryetari Hasani dhe zëvendëskryetari Cukalovic e kanë kuptuar dhe e kanë theksuar qartë këtë gjë: “paragrafi [113.2] *nuk* kërkon që institucionet e përmendura [përfshirë Avokatin e Popullit] të *kenë* interes direkt në çështjen që mund ta ngrinin para Gjykatës, apo edhe që të plotësojnë ndonjë kusht tjetër” (E. Hasani dhe I. Cukalovic, *Komentari: Kushtetuta e Republikës së Kosovës* (2013), f. 573, theksi në origjinal).

A mund të argumentohet që, megjithëse Avokati i Popullit kishte të drejtë të referonte çështjen në Gjykatën Kushtetuese, edhe Gjykata kishte të drejtë ta refuzonte sipas dëshirës së vet? Një pretendim i tillë sugjerohet kur Gjykata thekson në Aktvendim se: “Gjykata, në parim, ***mund*** të merret me kërkesa të parashtruara nga Avokati i Popullit” (*Aktvendimi*, par. 28), e cila nënkupton se ka raste në të cilat kërkesa e parashtruar plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore, por gjithsesi është brenda ***diskrecionit*** të Gjykatës të pranojë ose refuzojë kërkesën.

Mirëpo, kjo ide ***nuk ka asnjë bazë kushtetuese ose ligjore***. Gjykata nuk citon asnjë rast në jurisprudencën e vet, asnjë dispozitë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, asnjë nen të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, asnjë rregull të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese, që do të mund të mbështeste këtë lloj diskrecioni. Përkundrazi, siç konfirmohet në Komentarin e fundit mbi Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës: “Nëse një kërkesë është dorëzuar në Gjykatë nga një ose më shumë palë të lartpërmendura [përfshirë Avokatin e Popullit], ***Gjykata nuk mund ta refuzojë kërkesën si të papranueshme***, me kusht që të gjitha

kushtet tjera procedurale të jenë përmbushur” (Gj. Mushkolaj, V. Morina dhe J. van Lamoen, “Komentar: Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (2014), f. 307, theks i shtuar). Siç kemi vërejtur më sipër, në Rastin KO22/15 janë përmbushur të gjitha kushtet procedurale. Prandaj, Gjykata nuk kishte aspak të drejtë ta refuzojë kërkesën e Avokatit të Popullit.

C.

Përveç pretendimit që Avokati i Popullit mund të ngrëjë raste vetëm kur pretendon një shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Gjykata në *Aktvendim* përpiqet të kushtëzojë edhe më tej të drejtën e Avokatit të Popullit për të ngritur raste, duke pretenduar se kërkesa e Avokatit të Popullit në Rastin KO22/15 është bazuar në hetime *ex officio* “lidhur me procedurën që çoi deri në marrjen e Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin KO155/14”, ndërsa “Avokati i Popullit dhe autoritetet e tjera publike nuk kanë kompetenca kushtetuese për të hetuar procesin e vendimmarrjes së organeve të pavarura gjyqësore” (*Aktvendimi*, par. 41-42). Edhe për këtë arsye, sipas Gjykatës, kërkesa e Avokatit të Popullit ishte e papranueshme.

Gjykata, në mënyrë selektive dhe pa ndonjë lidhje kuptimore, citon disa autoritete në përpjekje për të mbështetur këtë pretendim. Së pari, e citon edhe një herë një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, duke pohuar se “Asnjë organ apo institucion tjetër . . . nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qëndror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. . . . Kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë . . . u është dhënë gjykatave” (*Aktvendimi*, par. 36, duke cituar Vendimin Nr. 19, të 31 majit 2010, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë). Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese harron thelbin e misionit të saj, interpretimin e Kushtetutës.

Së dyti, Gjykata përpiqet të mbështet pretendimin e vet tek një konferencë e avokatëve të popullit të vendeve evropiane, mbajtur në Lubjanë në vitin 2001, me titullin “Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore”. Kjo konferencë ka nxjerrë konkluzionin se “kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me degën gjyqësore të pushtetit mund të jenë vetëm në atë masë sa nuk e rrezikojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe paanshmërinë e tyre në marrjen e vendimeve gjyqësore” (*Aktvendimi*, par. 40).

Së treti, për të dëshmuar për frikën e madhe që ka për shkak të shkeljeve të vazhdueshme procedurale dhe materiale të bëra në këtë rast konkret, Gjykata citon Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku parashikohet se “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese” (*Aktvendimi*, par. 46, duke cituar Kushtetutën, neni 117). Në të njëjtën linjë, Gjykata citon Aktgjykimin e vet në Rastin KO98/11 (parashtrues i kërkesës: Qeveria e Republikës së Kosovës, 20 shtator 2011), në të cilin ka trajtuar çështjen e imunitetit parlamentar dhe i është referuar “lirimi[t] nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura,

mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si deputetë dhe veprimet e tjera të ndërmarra gjatë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre” (*Aktvendimi*, par. 47).

Bazuar në citimin e këtyre autoriteteve, Gjykata nxjerr konkluzionin se, kërkesa e Avokatit të Popullit duhet të refuzohet sepse është fryt i një hetimi ndaj gjyqësorit që ka dalë jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit. Mirëpo, para se t’i shqyrtojmë me hollësi nëse autoritetet e cituara në të vërtetë e mbështesin pozicionin e Gjykatës, duhet vërejtur që, nga këndvështrimi i Kushtetutës dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, çfarëdoj opiniononi a përshtypje personale që kanë Gjykata Kushtetuese dhe anëtarët e saj për legjitimitetin e hetimeve që kanë rezultuar në kërkesën e Avokatit të Popullit, është plotësisht jorelevante për procesin e vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës së parashtruar.³ Nuk ekziston asnjë dispozitë kushtetuese ose ligjore që i jep të drejtën Gjykatës që të refuzojë një kërkesë të Avokatit të Popullit, në bazë të opinionëve dhe përshtypjeve të tilla. Siç kemi vërejtur më sipër, ***Avokati i Popullit gëzon kompetencën për të ngritur çështjen e kushtetutshmërisë së dekreteve të Presidentit para Gjykatës Kushtetuese, dhe kjo kompetencë është e pakushtëzuar***. Gjykata nuk ka të drejtë të refuzojë një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dekretit të Presidentit, me pretekst që nuk i pëlqejnë hetimet që kanë nxitur Avokatin e Popullit për ta ngritur çështjen.

Kjo pikë më vete do të mjaftonte për të hedhur poshtë pretendimin e Gjykatës se kërkesa e Avokatit të Popullit është e papranueshme. Por, ia vlen për të theksuar se, opiniononi i Gjykatës lidhur me hetimet e Avokatit të Popullit, nuk është vetëm ***jorelevant*** por edhe ***i pasaktë***. Avokati i Popullit ka vepruar plotësisht brenda kufijve të kompetencave të tij kur ka hapur hetime *ex officio* për parregullësitë procedurale të evidentuara në Rastin KO155/14. Të gjitha citimet nga autoritetet e cekura nga Gjykata, pa përjashtim, dështojnë plotësisht të mbështesin pozicionin e saj mbi këtë pikë.

Së pari, nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e Avokatit të Popullit fakti që, sipas Kushtetutës, “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra brenda fushës së përgjegjësisë si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese”. Avokati i Popullit, as në hetimet e tij të parregullësive në trajtimin e Rastit KO155/14, as në çështje të tjera, kurrë nuk ka ndjekur penalisht gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, kurrë nuk ka ngritur padi civile kundër tyre dhe kurrë nuk ka iniciuar ndonjë procedurë për shkarkimin e tyre nga detyra për vendimet e marra. Avokati i Popullit nuk ka kompetencë për të ndërmarrë veprime të tilla dhe asnjëherë nuk ka pretenduar t’i ketë këto

³ Po ashtu, ia vlen të theksohet se opiniononi i Gjykatës është jorelevant edhe për vetë Avokatin e Popullit, i cili “nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës” (Kushtetuta, neni 132, par. 2). Ai që ka fjalën e fundit për ligjshmërinë e hetimeve të Avokatit të Popullit është vetë Avokati i Popullit, jo Gjykata Kushtetuese apo ndonjë institucion tjetër, dhe Avokatit të Popullit nuk i intereson, as nuk duhet t’i interesojë, se çfarë mendimi ka Gjykata Kushtetuese për mënyrën se si ushtron funksionin e vet Avokati i Popullit. Roli i Gjykatës Kushtetuese, në fazën e vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesave, është vetëm të shqyrtojë nëse parashtruesi që ka ngritur kërkesën përmbush kriteret e parashikuara me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, për referimin e rasteve tek kjo Gjykatë. Ofrimi i mendimeve të Gjykatës për çfarëdoj hetimesh, mendimesh apo veprimesh që e kanë shtyrë parashtruesin të paraqesë kërkesën e tij, është totalisht i papranueshëm dhe jorelevant në këtë proces vlerësimi.

kompetenca. Sigurisht, është e vërtetë se Avokati i Popullit i është përgjigjur në mënyrë të plotë kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për dorëzimin e dëshmimeve për hetimet e tyre ndaj kyretarit Hasani dhe gjyqtarës Rama-Hajrizi, lidhur me mundësinë që këta të kenë kryer vepra penale lidhur me Rastin KO155/14, por Avokati i Popullit asnjëherë nuk ka luajtur vetë rolin e prokurorit. Për më tepër, bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me hetimet e Prokurorisë Speciale ka filluar më datë 4 mars 2015, gjashtë ditë pasi është dorëzuar Rasti KO22/15 në Gjykatë. Prandaj, ky bashkëpunim, edhe po të supozojmë se ka tejkaluar kompetencat e Avokatit të Popullit, gjithsesi nuk përbënte asnjë pjesë të kërkesës së parashtruar në Rastin KO22/15. Për këto arsye, ideja e Gjykatës që hetimet *ex officio* të Avokatit të Popullit, gjoja kanë shkelur imunitetin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, është *e shpikur*. Ky pretendim nuk ka asnjë bazë faktike dhe ligjore, dhe, pavarësisht nga kjo, nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e parashtruar nga Avokati të Popullit më 26 shkurt 2015.

Po ashtu, konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, “Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore”, njëlloj si Rasti KO97/12 i analizuar më sipër, jo vetëm që *nuk e mbështet* pozicionin e Gjykatës, por edhe *e kundërshton plotësisht*. Është e vërtetë se në konkluzionet e Konferencës thuhet se “kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me degën gjyqësore të pushtetit mund të jenë vetëm në atë masë sa nuk e rrezikojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe paanshmërinë e tyre në marrjen e vendimeve gjyqësore”. Por, mu në fjalinë tjetër pas pjesës së cituar nga Gjykata, vazhdojnë këto fjalë: “Ndërhyrja e Avokatit të Popullit, ku lejohet me ligj, . . . *mund të adresojë aspektet procedurale të administrimit të rasteve individuale*” (Konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, “Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore”, par. 4, theks i shtuar). Të pyesim edhe një herë: *A nuk i ka lexuar Gjykata Konkluzionet e Konferencës deri në fund, para se ta citonte, apo thjesht nuk ka pritur që lexuesit e Aktvendimit do ta kontrollonin vetë këtë citim?* Sido që të jetë, në Republikën e Kosovës, hetimet e Avokatit të Popullit në aspekte procedurale të lëndëve të trajtuara nga gjyqësori lejohen shprehimisht “në raste të . . . keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit” (Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 16, pika 6). Në Rastin KO155/14, me mospërfundimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe kryetarit Hasani, me gjithë konfliktin e tyre të interesit, kishte mjaft evidencë të “keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit”. Kjo do të thotë se, edhe sipas vetë autoritetit të cituar nga Gjykata, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka vepruar plotësisht brenda kompetencave të tij kur ka hapur hetime *ex officio* lidhur me parregullësitë procedurale të Rastit KO155/14.

Për të njëjtat arsye, nuk ka asnjë lidhje me këtë çështje edhe pohimi i cituar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë se: “Asnjë organ apo institucion tjetër . . . nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qëndror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. . . . Kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë . . . u është dhënë gjykatave”. Avokati i Popullit, as gjatë hetimeve të tij në Rastin KO155/14, as gjatë hetimeve në raste të tjera, kurrë nuk ka pretenduar të marrë kompetencën për “trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve” që u takojnë gjykatave. E vetmja gjë që ka bërë Avokati i Popullit lidhur me Rastin KO155/14, ishte

të ushtrojë kompetencën e tij ligjore për të hetuar evidencë të “keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit” në trajtimin e këtij rasti.

Për këto arsye, pretendimi i Gjykatës Kushtetuese se hetimet e Avokatit të Popullit kanë tejkaluar kompetencat e tij, është po aq i pasaktë sa është jorelevant për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Avokatit të Popullit. Ky është thjesht një pretendim tendencioz me qëllim ikjeje nga e vërteta, sipas parimit: mënyra më e mirë për mbrojtje është sulmi. Dhe pikërisht ky është tejkallim banal dhe arrogant i kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

II. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese pretendon se nuk kishte nevojë për kuorumin prej shtatë gjyqtarësh për të nxjerrë Aktvendimin në Rastin KO155/14, por ky pretendim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, si dhe me shpjegimet e mëparshme të vetë Gjykatës Kushtetuese në prononcimin e saj për media.

Siç është cekur në kërkesën e Avokatit të Popullit në Rastin KO22/15, Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 19, par. 2, përcakton shprehimisht që “Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë”. Pa e përmbushur kuorumin në një rast të caktuar, Gjykata Kushtetuese nuk mund të nxjerrë asnjë vendim në këtë rast. Por, në Rastin KO155/14, megjithëse emrat e shtatë gjyqtarëve paraqiten në faqen e parë të Aktvendimit në Rastin KO155/14, emri i gjyqtarit Carolan nuk do të duhej të ishte përfshirë në listë, siç është konfirmuar më vonë nga vetë gjyqtari Carolan. Në një letër të dërguar personalisht nga gjyqtari në selinë e Institucionit të Avokatit të Popullit më 13 shkurt 2015, ai ka deklaruar se: “nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten që më parë nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me [Rastin KO155/14]”. Bashkëngjitur me këtë letër, gjyqtari Carolan ka dërguar gjithashtu një komunikim të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, i cili, sipas tij, konfirmon përjashtimin e tij nga procedura e rastit. Në bazë të kësaj deklaratë të gjyqtarit Carolan, bashkë me refuzimin ose dështimin e kryetarit Hasani dhe gjyqtares raportuese Rama-Hajrizi për të shpjeguar përfshirjen e gjyqtarit Carolan në listë, Avokati i Popullit ka argumentuar në kërkesën e tij të fundit që Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO155/14, ishte i pavlefshëm nga ana ligjore për shkak se nuk kishte kuorumin e duhur prej shtatë gjyqtarësh.

Reagimi i parë zyrtar i Gjykatës Kushtetuese pas daljes së këtij skandali ka qenë po aq i pabesueshëm sa ishte joprofesional. Instinkti i parë i Gjykatës, pas ngritjes së dyshimeve të arsyeshme për falsifikimin e dokumentit zyrtar, ishte (1) të hedhë akuza qesharake mbi Avokatin e Popullit për “shantazh ndaj punës së [Gjykatës]” dhe (2) të hedhë fajin për krejt skandalin mbi vetë gjyqtarin Carolan, duke pretenduar se “gjyqtari nuk ka ndjekur rrugën e kërkuar ligjore” dhe që “një kërkesë për përjashtim nga diskutimi është paraqitur nga gjyqtari Robert Carolan një ditë para mbarimit të afatit dhjetëditor, por që ka ardhur në zyrën e Kryetarit të Gjykatës pas

publikimit të vendimit” (Gjykata Kushtetuese, “Njoftim për medie”, 3 mars 2015). Në të njëjtin njoftim për medie, Gjykata thekson se “asnjëherë dhe në asnjë rast deri më sot nuk ka pasur probleme me kuorumin e saj, që d.m.th. se çdo herë dhe në secilin rast ka pasur kuorumin e duhur si Gjykatë” (*po aty*).

Kjo përpjekje e Gjykatës për të nxjerrë veten nga skandali, duke hedhur fajin mbi gjyqtarin Carolan, pavarësisht se përbën një shenjë të joprofesionalizmit të jashtëzakonshëm, për më tepër dështon plotësisht edhe në substancë, për shkak se është bazuar në një të pavërtetë, e cila jo vetëm që nuk e sqaron çështjen, por edhe lind dyshime të mëtejshme. Përkatësisht, nuk është e vërtetë që kërkesa e gjyqtarit Carolan ka ardhur vetëm një ditë para mbarimit të afatit dhjetëditor. Në komunikimin e tij brenda Gjykatës, të shënuar me datë 12 nëntor 2014, gjyqtari Carolan u kishte shkruar dy zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar një letre me anë të së cilës e kishte përjashtuar veten nga shqyrtimi dhe vendimi i Rastit KO155/14. Meqenëse rekomandimi i kolegjit shqyrtues për papranueshmërinë e rastit i është dërguar përbërjes së plotë të Gjykatës më 4 nëntor 2014 (shih Aktvendimin, Rasti KO155/14, par. 11), kjo do të thotë që gjyqtari Carolan kishte kërkuar përjashtimin e tij, të paktën dy ditë para afatit dhjetëditor, i cili do të përfundonte më 14 nëntor 2014. Por, në vend që të shqyrtonte kërkesën e gjyqtarit Carolan për përjashtim, Gjykata Kushtetuese vendosi të publikojë Aktvendimin e saj më 13 nëntor 2014, një ditë para mbarimit të afatit dhjetëditor. Kjo shkelje e afatit ligjor lind dyshimin që dikush brenda Gjykatës, duke e ditur për kërkesën e gjyqtarit Carolan, **qëllimisht** ka përshpejtuar publikimin e Aktvendimit, duke shkelur afatin ligjor, me qëllim që të mos ketë mundësi të shqyrtohej kërkesa e gjyqtarit Carolan me kohë dhe në këtë mënyrë, të mos rrezikohet kuorumi prej shtatë gjyqtarësh. Në një deklaratë të lëshuar për media me datë 3 mars 2015, Avokati i Popullit ka ngritur shqetësimin e tij lidhur me këtë shkelje të afatit ligjor. Mirëpo, Avokati i Popullit akoma është duke pritur një sqarim a justifikim prej Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje.

Siç duket, në Aktvendimin e Rastit KO22/15, Gjykata ka qenë e paaftë për të shpikur një sqarim a justifikim të tillë. Kjo paaftësi evidentohet nga fakti se në Aktvendim Gjykata përpiket ta fshehtë shkeljen në tërësi, duke përmendur vetëm që Aktvendimi i Rastit KO155/14 “u publikua në Gazetën Zyrtare më 17 nëntor 2014” (*Aktvendimi*, par. 58), pa e treguar që data kur Aktvendimi është publikuar zyrtarisht nga vetë Gjykata ishte 13 nëntor 2014. Kjo datë paraqitet qartë në faqen e parë të Aktvendimit të Rastit KO155/14, dhe fatkeqësisht për Gjykatën, ky Aktvendim është bërë publik (më 13 nëntor, jo 17 nëntor), dhe rrjedhimisht, data e nxjerrjes së tij nuk mund të fshihet më.

Duke pasur dëshirë t’i shmanget sa më shpejtë shkeljes së dukshme të afatit ligjor dhjetëditor, Gjykata vendosi në Aktvendimin e Rastit KO22/15 të ndryshojë papritmas taktikat e saj. Tani, Gjykata nuk po pretendon më se kishte kuorumin e duhur në Rastin KO155/14 dhe që gjyqtari Carolan “nuk ka ndjekur rrugën e kërkuar ligjore”. Në vend të këtij shpjegimi të dështuar, Gjykata paraqet një justifikim tjetër, i cili, për fat të keq, del edhe më i dështuar se i pari. Në vend që të pretendojë se kishte pasur kuorumin e duhur prej shtatë gjyqtarësh në Rastin KO155/14, ashtu si kishte bërë në njoftimin e tij për media, Gjykata në Aktvendimin e Rastit

KO22/15 pretendon se nuk paska pasur nevojë fare për kuorum, në radhë të parë. Sipas Gjykatës, “gjyqtari raportues i paraqet raportin Kolegjit shqyrtues për papranueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues diskuton për të dhe i rekomandon Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Nuk mbahet këshillim dhe votim i mëtejshëm”, dhe “pasi nuk mbahet këshillim dhe votim i mëtejshëm, **me Ligj nuk kërkohet kuorumi prej 7 (shtatë) gjyqtarësh**” (Aktvendimi, par. 51-52).

Ideja që nuk ka nevojë për plotësimin e kuorumit për shqyrtimin e pranueshmërisë së kërkesave, është edhe një risi tjetër e shpikur e Gjykatës, sepse nuk ka asnjë bazë ligjore. Siç ka argumentuar Avokati i Popullit në kërkesën e tij, megjithëse kolegji shqyrtues i rastit **fillimisht** e vlerëson çështjen e pranueshmërisë së një kërkesë (shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, neni 22, par. 6), kolegji mund të nxjerrë vetëm **propozim**-vendim për papranueshmëri. Pastaj “kolegji ia dërgon **të gjithë** gjyqtarëve **propozim**-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë” (*po aty*, neni 22, par. 7, theks i shtuar). Shih gjithashtu Rregullin 35, par. 4, të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese (“[K]ryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit projektaktvendimin, i cili përmban arsyet për papranueshmërinë e kërkesës dhe ia dërgon atë *projektaktvendim* Sekretariatit. Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell atë **projektaktvendim të gjithë gjyqtarëve për shqyrtim të mëtejshëm**, në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese”, theks i shtuar). Vetëm nëse gjyqtarët e tjerë nuk paraqesin kundërshtim, atëherë propozim-vendimi i kolegjit shqyrtues bëhet vendim i Gjykatës Kushtetuese (shih *po aty*, neni 22, par. 8). Prandaj, edhe për një rast të papranueshmërisë, projektvendimi i përgatitur nga kolegji shqyrtues duhet të shqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm, dhe prandaj, kuorumi i shtatë gjyqtarëve të pranishëm për këtë shqyrtim të mëtejshëm, duhet të përmbushet. Fakti që emrat e të gjithë gjyqtarëve të pranishëm listohen në faqen e parë të çdo aktvendimi për papranueshmëri, **përfshirë edhe ata që nuk janë zgjedhur si gjyqtar raportues ose anëtar i kolegjit shqyrtues**, përbën edhe një dëshmi tjetër që të gjithë gjyqtarët e pranishëm, duke i përfshirë ata që nuk janë anëtarë të kolegjit shqyrtues, përfshihen në shqyrtimin e rastit, përndryshe nuk do të listohen fare. Prandaj, kuorumi prej shtatë gjyqtarësh duhet patjetër të përmbushet për të gjitha vendimet e Gjykatës, përfshirë Aktvendimet për papranueshmëri. Të gjitha këto pika janë argumentuar me hollësi në kërkesën e Avokatit të Popullit (shih pjesën “A”), por, ashtu siç e ka zakonin, Gjykata nuk ka dhënë **asnjë përgjigje** kundër këtyre argumenteve.

Duke marrë parasysh dështimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese për të dëshmuar që kishte kuroumin e duhur në Rastin KO155/14, dhe dështimin e saj të plotë për të argumentuar që nuk kishte nevojë fare për kuorum, është bërë tepër e dukshme se Gjykata thjesht po provon çdo taktikë të mundshme për të fshehur të vërtetën për mungesën e kuorumit në Rastin KO155/14 dhe në këtë mënyrë të mashtrorë opinionin publik. Avokati i Popullit, edhe një herë, i bën thirrje Gjykatës Kushtetuese që të lë anash të gjitha përpjekjet për manipulime, gënjeshtat dhe shpikjet, të dalë me të gjitha faktet e rastit dhe, në këtë mënyrë, të lejojë publikun e gjerë që të gjykojë vetë nëse Gjykata Kushtetuese ka vepruar kundër ligjit, respektivisht nëse Gjykata Kushtetuese ka falsifikuar dokumentin e përmendur – Aktvendimin për rastin KO155/14 – apo jo.

III. Dështimi i Gjykatës për të përjashtuar kryetarin Hasani dhe gjyqtarët Botusharova-Doicheva dhe Rodrigues nga pjesëmarrja në procedurën e Rastit KO22/15, ka qenë plotësisht i pajustificuar dhe i paarsyetuar, si dhe është në kundërshtim të plotë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese dhe Kodin e mirësjelljes për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Bashkë me kërkesën kryesore për shfuqizimin e Dekretit të Presidentes për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë në Rastin KO22/15, Avokati i Popullit ka dërguar tek Gjykata Kushtetuese një kërkesë tjetër, për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës, z. Enver Hasani, nga pjesëmarrja në procedurën e rastit. Në përputhje me Rregullin 7, pika 2, të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese (“Në petition, pala duhet t’i prezantojë faktet dhe rrethanat me të cilat e arsyeton përjashtimin e gjyqtarit”), kërkesa e Avokatit të Popullit është arsyetuar, madje është arsyetuar me hollësi. Përkatësisht, Avokati i Popullit argumentoi se kishte arsye të mjaftueshme për përjashtimin e Kryetarit Hasani nga pjesëmarrja në procedurë për shkak të (1) angazhimit të tij në diskutime të brendshme të EULEX-it dhe të Bashktimit Evropian mbi procedurën e emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe (2) pohimit eksplícit të kryetarit Hasani që anashkalimi i Kuvendit nuk do të paraqiste shkelje kushtetuese në këtë rast.

Në kërkesën e Avokatit të Popullit, këto pretendime faktike për veprimet e kryetarit Hasani lidhur me këtë çështje, janë mbështetur me citime nga burime mediale. Këto burime kanë përfshirë publikimin e një memorandumit të brendshëm të Misionit EULEX, dokument zyrtar i Misionit EULEX i cili nuk është përgënjeshtuar apo mohuar asnjëherë nga EULEX-i, në të cilin një këshilltar ligjor i vetë Misionit ka konfirmuar që kryetari Hasani kishte dhënë miratimin e tij për pikërisht atë procedurë për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, që Avokati i Popullit po kontestonte në Rastin KO22/15. Gjithashtu, kërkesa e Avokatit të Popullit ka cituar një intervistë të dhënë nga vetë kryetari Hasani për emisionin *Betimi për Drejtësi*, në të cilën ai vetë ka konfirmuar shprehimisht se ka pasur bisedime me zyrtarë të Bashkimit Evropian për të siguruar vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Siç tregohet nga Rasti KK124/14, *Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu*, 20 gusht 2014, raportime mediale mund të shërbejnë si bazë e mjaftueshme për përjashtimin eventual të një gjyqtari nga procedura e një ose disa rasteve të ngritura para Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të këtyre raportimeve, Avokati i Popullit ka arsyetuar se janë përmbushur kriteret për përjashtimin e kryetarit Hasani, siç janë përcaktuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, neni 18, pikat 1.1 dhe 1.3 (“Gjyqtari përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë . . . me kërkesë të palës kur gjyqtari . . . është i përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese; . . . ose sipas detyrës zyrtare është marrë më herët me çështjen para se ajo t’i jetë referuar Gjykatës Kushtetuese”), si dhe në Kodin e mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, neni 2.2 (“Gjyqtarët duhet të kujdesen që të shmangin të gjitha konfliktet e interesit dhe duhet të përjashtojnë veten nga pjesëmarrja në çdo rast në të cilin mund të vihet në pikëpyetje anshmëria

e tyre”).

Të gjitha pikat e lartpërmendura, faktike edhe ligjore, ishin argumentuar gjatë në kërkesën e Avokatit të Popullit. Megjithatë, në një ndër vendimet më absurde dhe qesharake në gjithë historinë e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata ka vendosur t’i mbyllë sytë plotësisht, duke u shtirë sikur Avokati i Popullit nuk kishte paraqitur asnjë argument ose dëshmi të vetme: “Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit është e paarsyetuar, irelevante dhe e paargumentuar. . . . Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesit” (Rasti Nr. KO22/15, Vendim, 17 prill 2015, *Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*, par. 11-12). Me zbardhjen e falsifikimit të Aktvendimit të Rastit KO155/14, ishte bërë e ditur që më parë se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë problem për të gënjer haptas në një vendim zyrtar, për të arritur qëllimet e veta. Por tani, me daljen e vendimit për mospërjashtimin e kryetarit Hasani, është bërë e ditur gjithashtu se Gjykata Kushtetuese, fatkeqësisht, jo vetëm gënjen, por është gjithashtu e paaftë të mësojë nga përvoja.

Por, me gjithë tendencën e Gjykatës për të gënjer haptas në vendimet e saj zyrtare, Avokati i Popullit është interesuar për të ditur nëse Gjykata kishte ndonjë arsye, ndonëse të pashprehur në Vendim, që do të mund të justifikonte mospërjashtimin e kryetarit Hasani. Përkatësisht, në paragrafin 7 të Vendimit, pretendohet se: “Më 17 prill 2015, Gjykata mori një deklaratë nga Kryetari i Gjykatës në pajtim me rregullin 7.4 të Rregullores së punës”. Ky rregull përcakton se: “Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar, merret një deklaratë nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera.” Pa dashur të kritikojë Gjykatën Kushtetuese publikisht para se të merrte të gjitha faktet, Avokati i Popullit ka dashur të kuptojë nëse deklaratat e kryetarit Hasani mund të kishte shërbyer si bazë për mospërjashtimin e tij, dhe për këtë arsye ka dërguar dy përfaqësues të tij tek selia e Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar qasje në këtë dokument. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 132, par. 3, “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”). Gjithashtu, Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 6, përcakton qartë se: “Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t’i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo institucion i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, duke përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.”

Mirëpo, në takimin e zhvilluar më 22 maj 2015 në selinë e Gjykatës Kushtetuese, zyrtarë të Gjykatës kanë refuzuar kërkesën e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit për qasje në dokumentin në fjalë, duke pretenduar se ky dokument ishte “konfidencial” dhe duke u thirrë në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në krahasim me kompetencat e Ombudsmanëve të vendeve të tjera, në veçanti Ombudsmani i Suedisë. Zyrtarët e Gjykatës të pranishëm në takim, duke vazhduar një traditë të moçme të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, nuk kanë cituar asnjë rast të Gjykatës Evropiane, dhe asnjë dispozitë kushtetuese ose ligjore, që

do të mund të mbështeste mohimin e së drejtës së Avokatit të Popullit për të pasur qasje në dokumentin e kërkuar. Por, ia vlen për të theksuar se, edhe po të kishin cituar ndonjë autoritet ligjor ose juridik, kjo prapëseprapë nuk do të kishte qenë bazë e mjaftueshme për të justifikuar refuzimin e qasjes. Siç është e dukshme nga dispozitat e cituara më lart, e drejta e Avokatit të Popullit për qasje në dosje dhe dokumente publike është e pakufizuar **në Republikën e Kosovës**, pavarësisht nga çfarëdoj praktikash që mund të ndiqen në vende të tjera. Duke i refuzuar Avokatit të Popullit qasje në dokument publik, Gjykata Kushtetuese, edhe një herë, ka shkelur haptas Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Ky refuzim për bashkëpunim dhe për qasje në dokumentet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese dhe bashkëpunëtorëve të saj, “përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil” (Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 23, par. 2), sepse “Të gjitha organet e pushtetit shtetëror kanë për obligim ta ndihmojnë Avokatin e Popullit në zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij” (*po aty*, par. 1).

Për më tepër, ideja që përmbajtja e deklaratës së kryetarit Hasani ishte “konfidenciale”, kundërshton qartazi praktikën e vetë Gjykatës Kushtetuese. Në Rastin KK124/14, të përmendur më lart, Gjykata ka përshkruar, në mënyrë të hollësishme, përmbajtjen e deklaratave të marra prej gjyqtarit Kryeziu (shih par. 14, nënpar. g, gj, j, k, l, ll, m dhe n, si dhe par. 15). Duke marrë parasysh mënyrën tepër të lirshme në të cilën Gjykata ka diskutuar, në një vendim të lëshuar për publik, hollësitë e deklaratave të gjyqtarit Kryeziu, Avokati i Popullit e konsideron jashtëzakonisht jo të sinqert, jo të ndershëm dhe joetik pretendimin e Gjykatës që deklaratat e kryetarit Hasani në Rastin KO22/15 ka qenë, gjoja, “konfidenciale”.

Në fund të fundit, pavarësisht nga shkelja e dukshme e Kushtetutës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, bashkë me mospërputhjen me praktikën e vetë Gjykatës Kushtetuese, pyetja më thelbësore që akoma kërkon përgjigje është, **çfarë ka për të fshehur këtu?** Çfarë arsyeje ka Gjykata Kushtetuese për t’u frikësuar nga zbulimi i deklaratës së kryetarit Hasani para publikut? Deklarata e kryetarit Hasani nuk kishte të bënte me ndonjë çështje private, as nuk ishte e asaj natyre që do të kërcënonte sigurinë kombëtare, as sigurinë fizike të ndonjë individi. Deklarata në fjalë është dhënë si dëshmi në një rast publik, për një çështje krejt zyrtare dhe jopersonale. Avokati i Popullit, gjatë gjithë mandatit të tij deri tani, asnjëherë nuk ka hasur një rast në të cilin një gjykatë e Republikës së Kosovës, ka vendosur të mbajë të fshehur deklaratën e një dëshmitari në një rast publik, pa asnjë justifikim në lidhje me privatësinë ose sigurinë e një individi, apo me sigurinë e shtetit në përgjithësi. Refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të bërë publike deklaratën e kryetarit Hasani, tregon përsëri se Gjykata është e gatshme edhe për të fshehur dëshmi zyrtare për t’u shërbyer interesave të veta. Fshehja e dëshmimeve gjatë procedurës zyrtare, duke përfshirë hetimet në procedurë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është vepër e dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 394 (“Pëngimi i të provuarit apo procedurës zyrtare”).

Përveç dështimit të Gjykatës për të përjashtuar kryetarin Hasani nga pjesëmarrja në procedurën e Rastit KO22/15, dështimi për të përjashtuar gjyqtarët ndërkombëtarë Botusharova-

Doicheva dhe Rodrigues kanë qenë gjithashtu shumë shqetësues. Në paragrafin 8 të Aktvendimit, është pretenduar se: “Më 2 mars 2015, gjyqtari Robert Carolan kërkoi me shkrim nga Kryetari i Gjykatës që t’i lejohej përjashtimi ‘nga pjesëmarrja në këshillime dhe në votim për këtë rast’, në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.1, të Ligjit [për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës] dhe në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese”. Pastaj, Aktvendimi pohon se “Gjykata . . . shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit Robert Carolan për përjashtimin e tij dhe vendosi, me shumicë votash, që të lejojë kërkesën e tij. . . , pasi gjyqtari Robert Carolan mund të përballet me konflikt interesi” (par. 10).

Por, megjithëse Gjykata ka vendosur se kishte pasur baza të mjaftueshme për përjashtimin e gjyqtarit Carolan, nuk i ka përjashtuar edhe dy gjyqtarët e tjerë ndërkombëtarë, gjyqtarët Botusharova-Doicheva dhe Almiro Rodrigues. Njësoj si gjyqtari Carolan, gjyqtarët Botusharova-Doicheva kanë përmbushur kriteret për përjashtimin nga procedura e rastit, sepse ishin “përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 18, pika 1.1). Megjithatë, Gjykata ka përjashtuar gjyqtarin Carolan, ndërsa gjyqtarët Botusharova-Doicheva dhe Rodrigues kanë mbetur në trupin gjykues, edhe pse sikurse edhe “gjyqtari Carolan mund të përballet me konflikt interesi”. Mospërjashtimi i këtyre dy gjyqtarëve ka rrezik të paraqesë një shkelje të rregullit 7, par. 5 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese, i cili përcakton shprehimisht se: “Nëse ndonjë gjyqtar i Gjykatës mëson për ndonjë arsye për përjashtimin e ndonjë gjyqtari tjetër, siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Gjykat[ën], ai/ose ajo njofton Kryetarin e Gjykatës, i cili kërkon përgjigje nga gjyqtari. Nëse arsyeja është e bazuar mirë dhe gjyqtari nuk vetë-përjashtohet, Gjykata me shumicë votash të gjyqtarëve, vendos përkritazi me përjashtimin”.

Si në rastin e deklaratës së kryetarit Hasani, Avokati i Popullit nuk ka dashur të paragjykojë arsyet pse vetëm gjyqtari Carolan, por jo edhe dy gjyqtarët e tjerë ndërkombëtarë, është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurë. Për të vlerësuar sa më saktësisht nëse kanë ekzistuar ose jo arsye për përjashtimin e gjyqtarëve Botusharova-Doicheva dhe Rodrigues që ishin të ngjashme me arsyet që Gjykata ka pranuar si bazë të mjaftueshme për përjashtimin e gjyqtarit Carolan, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, në të njëjtin takim në të cilin kanë kërkuar qasje në deklaratën e kryetarit Hasani, kanë kërkuar edhe qasje në letrën ku gjyqtari Carolan ka cekur arsyet për përjashtimin e tij nga procedura. Shih Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese, Rregulli 7, pika 1 (“Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim të arsyeshem përkitazi me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë dhe do t’ia shpjegojë arsyen me shkrim Kryetarit të Gjykatës. Një kopje e atij shpjegimi do t’u dërgohet të gjithë gjyqtarëve”). Por, duke u thirrë përsëri në “konfidencialitetin”, me qëllim që të mbajë të fshehur dëshmi në një rast publik, Gjykata ka refuzuar t’i lejojë Avokatit të Popullit qasje në këtë dokument. Fshehja e dëshmimeve vazhdon të mbetet vepër e dënueshme me ligj.

IV. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO22/15 pretendon se Dekreti i Presidentes është në linjë me marrëveshjen ndërkombëtare, por, njësoj si në Rastin KO155/14, nuk jep asnjë argument për këtë pretendim, nuk citon asnjë fjalë të marrëveshjes ndërkombëtare që mund të mbështesë këtë interpretim dhe nuk i përgjigjet asnjë argumenti të Avokatit të Popullit mbi këtë pikë.

Përderisa Gjykata harxhon më shumë se 30 paragrafe duke pretenduar se kërkesa e Avokatit të Popullit ishte e papranueshme dhe rrjedhimisht, nuk ka nevojë të konsiderojë substancën e saj, lexuesit e Aktvendimit mund të çuditen kur Gjykata, megjithatë, vazhdon pikërisht të konsiderojë substancën e kërkesës së Avokatit të Popullit. Sido që të jetë, Rasti KO22/15 i ka dhënë Gjykatës një mundësi të dytë për t'iu përgjigjur argumenteve substanciale lidhur me kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentes, argumentet që u paraqitën për herë të parë në Rastin KO155/14, u shpërfillën plotësisht nga Gjykata dhe u paraqitën për të dytën herë në Rastin KO22/15. Fatkeqësisht, në Aktvendimin e fundit, Gjykata i ka mbyllur sytë përsëri ndaj argumenteve të Avokatit të Popullit, nga njëra anë duke u përqëndruar tek pikat që edhe Avokati i Popullit nuk i ka vënë në dyshim në kërkesën e tij, dhe nga ana tjetër duke insistuar, pa asnjë argument ose dëshmi të vetme, që Dekreti i Presidentes ishte në përputhje me Kushtetutën.

Fillimisht, “Gjykata rikujton se Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës është kushtetues, pasi është nxjerrë në bazë të obligimeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian” (*Aktvendimi*, par. 61). Gjithashtu, “[p]ërmbajtja e Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës është përcaktuar me marrëveshjen bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian” dhe që “[ë]shtë obligim kushtetues i Presidentes së Republikës së Kosovës që ta bartë këtë tekst, ashtu siç është, nga marrëveshja bilaterale në Dekretin e saj dhe ta ekzekutojë atë nëpërmjet Dekretit të saj” (*po aty*, par. 62).

Mirëpo, argumenti kryesor i Avokatit të Popullit ka qenë që as dispozitat relevante kushtetuese, as përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare në fjalë, nuk i kanë lejuar Presidentes që të vazhdojë mandatin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pas përfundimit të këtij mandati, pa u propozuar këta gjyqtarë nga ana e Kuvendit (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, pjesa II, me titullin “*Vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet nga përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare e vitit 2014 midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian*” f. 10-22). Në vend që të merret drejtëpërsëdrejti me këtë argument kryesor të Avokatit të Popullit, Aktvendimi pretendon **pa asnjë arsytim** që Dekreti “është nxjerrë në bazë të obligimeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”. Gjithashtu, kur Gjykata pretendon se “[ë]shtë obligim kushtetues i Presidentes së Republikës së Kosovës që ta bartë këtë tekst, ashtu siç është, nga marrëveshja bilaterale në Dekretin e saj dhe ta ekzekutojë atë nëpërmjet Dekretit të saj”, Gjykata nuk jep **asnjë citim** të Marrëveshjes në fjalë për të treguar se pikërisht cila pjesë e tekstit të saj e ka detyruar ose lejuar Presidenten Jahjaga të nxjerrë Dekretin e kontestuar nga Avokati i Popullit.

Sidoqoftë, nuk është e habitshme që Gjykata nuk ka cituar asnjë pjesë të Marrëveshjes që do të mund të mbështeste nxjerrjen e Dekretit, sepse nxjerrja e Dekretit nuk mbështetet nga asnjë pjesë e Marrëveshjes, gjë që Avokati i Popullit ka argumentuar me hollësi.

Pastaj, njësoj si në Rastin KO155/14, Gjykata thekson disa pika që Avokati i Popullit nuk i ka kundërshtuar në kërkesën e tij. Për shembull, Gjykata deklaron se “Kushtetutshmëria e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje nuk mund të vlerësohet nga Gjykata” dhe që “Dekreti u ratifikua me shumicën e 2/3 të Kuvendit të Republikës së Kosovës” (*Aktvendimi*, par. 61-62). Këto pika nuk i ka kontestuar fare Avokati i Popullit në kërkesën e tij (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, f. 11 “[K]jo kërkesë nuk konteston aspak kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”). Në vend të kësaj, argumenti kryesor i Avokatit të Popullit ka qenë që as dispozitat relevante kushtetuese, as përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare në fjalë, nuk i lejojnë Presidentes që të vazhdojë mandatin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pas përfundimit të këtij mandati, pa u propozuar këta gjyqtarë nga ana e Kuvendit (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, §II, me titullin “*Vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet nga përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare e vitit 2014 midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian*” f. 10-22). Edhe Gjykata Kushtetuese nuk pretendon se këtë propozim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e kanë marrë tre gjyqtarët ndërkombëtarë.

Siç ka vërejtur Avokati i Popullit edhe për Aktvendimin e Gjykatës në Rastin KO155/14, ***një ndër pyetjet kryesore të këtij rasti*** ka qenë nëse Dekreti i Presidentes “është nxjerrë në bazë të obligimeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.” Fakti që Gjykata ka vendosur të trajtojë një ndër pyetjet kryesore të një rasti ***pa arsyetim, pa citim, dhe pa iu përgjigjur asnjë argumenti të parashtruesit*** pikërisht mbi këtë pyetje, tregon një varfëri shqetësuese të shtjellimit juridik, si dhe një shpërfillje të standardeve më elementare të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Duke përsëritur të njëjtat gabime që janë vërejtur në Rastin KO155/14, Aktvendimi i Rastit KO22/15 dëshmon edhe një herë që Gjykata Kushtetuese është e paaftë për t’iu përgjigjur argumenteve të Avokatit të Popullit, si dhe e paaftë për të mësuar nga e kaluara.

Me nderime

Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje:

- Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli.
- Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Enver Hasani
- Kryetares së ardhshme të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi